

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut urban”.

-Loti i I-rë: “Ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut urban – Infrastrukturë Komunikimi (Dark Fiber dhe Internet)”.

-Loti i II-të: “Ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut urban – Shërbim data nëpërmjet kartave sim”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbimet e internetit (72400000-4) Shërbime të monitorimit të trafikut (63712710-3).

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **39,929,022** (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e njëzet e nëntë mijë e njëzet e dy) lekë pa tvsh, ose **428,073.78** (katërqind e njëzet e tetë mijë e shtatëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e tetë) euro pa TVSH.

*** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 04/08/2026 është 93.28 Lekë/Euro.**

Loti i I-rë: “Ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut urban – Infrastrukturë Komunikimi (Dark Fiber dhe Internet)”, me fond limit: **32,619,290** (tridhjetë e dy milion e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH, ose **349,694.47** (treqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër pike dyzet e shtatë) euro pa TVSH

*** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në 04/08/2026 është 93.28 Lekë/Euro.**

Loti i II-të: “Ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut urban – Shërbim data nëpërmjet kartave sim”, me fond limit: **7,309,732** (shtatë milion e treqind e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, ose **78,363.34** (Shtatëdhjetë e tete mije e treqind e gjashtëdhjetë e tre pike tridhjetë e katër) euro pa tvsh.

*** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 04/08/2026 është 93.28 Lekë/Euro**

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të VKB-së Nr. 100 datë 18.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026” (i ndryshuar).

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër ose afati i zbatimit të kontratës: 24 (njëzet e katër) muaj kalendarik, nga data e aktivizimit të shërbimit.

**Afati kohor i ofrimit të shërbimit “Tabela 1 dhe 2, Situata Aktuale“, do të jetë për një periudhë kohore rreth 2 (dy) vjet / 731 (shtatëqind e tridhjetë e një) ditë, duke filluar nga data e aktivizimit të shërbimit.*

Faturimi i shërbimit për çdo pikë/vendndodhje (Situata aktuale, Situata e Pritshme) do të realizohet për sa kohë vendndodhja do të ketë shërbim aktiv. Në rast se ndonjë nga vendndodhjet/ pikat nuk do të duhet të jetë më aktive (në ofrimin e shërbimit) me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, vendndodhja /pika respektive nuk do të vijojë të faturohet nga operatori ekonomik.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Loti i I-rë: “Ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut urban – Infrastrukturë Komunikimi (Dark Fiber dhe Internet)”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

c. Formularin e Ofertës Ekonomike, sipas Shtojcës 1

d. Lista e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Neni 43, pika 4, të VKM nr. 285 “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy balance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen balance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.** (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit/ vlera e pritshme e kontratës së përlllogaritur për lot, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c dhe pika 5, si dhe neni 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

Pika 2/a: dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Vlera e përlllogaritur është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk

mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, pika 5, “Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 si dhe kështu për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).*

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, citohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë “Certifikatë e konfirmimit të njoftimit për sipërmarrësit” për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike sipas Regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, për shërbimet e kërkuara në këtë procedurë konkretisht për:

- Shërbimi i aksesit në internet
- Shërbimi i linjave me qera (Dark Fibër)

(Për operatorët e huaj ky kriter do të plotësohet duke dorëzuar licensën/autorizimin/certifikatën /dokumentin nga Autoritetet rregullatore përkatëse të origjinës së tyre).

Argumentimi:

Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

AKEP është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikqyr, kontrollon dhe monitoron veprimtaritë e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve

elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike. AKEP rezervon të drejtën të autorizojë një sipërmarrës/subjekt të ofrojë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, dhe i jep të drejtë të negociojë për interkoneksion dhe, kur është e zbatueshme, për të marrë akses nga sipërmarrësit e tjerë të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun si dhe të marri pjesë në përcaktimin si ofrues i shërbimit universal për shërbime të veçanta në skemën e shërbimit universal ose në pjesë të caktuara të territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, AKEP monitoron të gjithë infrastrukturën e çdo operatori i cili e ka të detyrueshme paraqitjen e shtrirjes së rrjetit të tij pranë AKEP sipas teknologjisë përkatëse që operatori disponon.

Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e certifikatës /autorizimit nga AKEP, për shërbimin objekt kontrate, është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kërkojë garanci mbi cilësinë e shërbimeve dhe të teknologjisë përkatëse që do të përdoret.

2.3.3 Operatori duhet të jetë i regjistruar në RIPE. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të regjistrimit pranë RIPE NCC.

Argumenti:

Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), ku citohet:

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

- a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*
- b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*
- c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*
- ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

RIPE NCC, si një regjistër rajonal interneti, ka autoritetin të delegojë burime interneti në zonën e tij të shërbimit dhe kryen aktivitete në dobi të antarëve të tij dhe palëve të interesuara.

Regjistrimi pranë RIPE NCC garanton për anëtarët një gamë të gjerë shërbimesh të anëtarësimit, siç janë mjetet e trajnimit dhe analizës së Internetit, që NCC RIPE ofron për të ndihmuar kompanitë anëtare me operacionet e tyre teknike.

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori duhet të ketë të paktën 2 (dy) lidhje ndërkombëtare për shërbimin e Internetit. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të kontratës/marrëveshjes me subjektet jashtë territorit të Shqipërisë mbi përdorimin e Aksesit Global në Internet.

Argumentimi:

Argumentimi

Referuar nenit 77 pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), parashikohet shprehimisht:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

Kërkesa për disponimin e të paktën 2 (dy) lidhje ndërkombëtare për shërbimin e internetit garanton Autoritetin për një performancë dhe disponueshmëri, rezervë alternative në rast të dështimeve, duke siguruar kështu një cilësi të lartë të ofrimit të shërbimit dhe duke garantuar një kontratë të suksesshme.

Nisur nga natyra dhe rëndësia e ofrimit të këtij shërbimi për Autoritetin Kontraktor, është në të drejtën e tij të sigurohet se Operatori Ekonomik i ka të gjitha kapacitetet për ekzekutimin dhe përmbushjen e kontratës, duke siguruar ofrimin e shërbimit në mënyrë të pandërprerë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

a) Standartin ISO 9001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

b) Standartin ISO 27001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigorisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

c) Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me standartin ISO 20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e

prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, nëpërputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

Argumentimi:

Bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"(i ndryshuar), Neni 44 - Kërkesat e cilësisë, pika 1, ku citohet:

"1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit."

- a) Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e ofrimit të shërbimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga ofruesi i shërbimit, fokusi i klientit, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca, profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimeve që ofron, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit, sigurimi i konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin.

Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Referuar sa më sipër, kërkesa për ISO 9001, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

- b) ISO 27001 është një kuadër standartizues përsa i përket garancisë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.

- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër, ky standard i kërkuar, lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi operatori ekonomik do të realizojë shërbimin e instalimit dhe konfigurimeve të nevojshme për vijueshmërinë e shërbimit të internetit e intranetit, dhe shërbimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme përgjatë afatit të kontratës, për të garantuar mbarëvajtjen e proceseve teknologjike të punës, shërbime të cilat domosdoshmërisht kërkojnë akses në infrastrukturën e autoritetit. Aksesit në infrastrukturën ekzistuese të Bashkisë për të realizuar shërbimet sa më sipër do të jetë i kontrolluar e monitoruar nga stafi i Bashkisë, megjithatë certifikimi ISO 27001 i operatorit ekonomik është një garanci e nevojshme që kërkohej.

c) Standardi ISO 20000-1 përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohet në teknologjitë e informacionit.

Kjo certifikatë siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet IT do të menaxhohen sipas standardeve me të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit, pasi të gjithë elementët e kontratës dhe komponentët përbërës, lidhen me shërbime të teknologjisë së informacionit.

2.3.6 Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, për të realizuar instalimet dhe konfigurimet e kërkuara si dhe për të garantuar suportin dhe garancinë përgjatë periudhës së parashikuar sipas specifikimeve teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë minimalisht punonjës të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- Të paktën 2 (një) punonjës të pajisur me certifikatë CCNA Certified Network Associate Routing & Switching ose ekuivalente;
- Të paktën 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë CS PS Core Network Planning, ose ekuivalente;
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar SCTE ose ekuivalente;

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose më shumë certifikime.

Argumentimi:

Bazuar në nenin 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) përcaktohet:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...*”

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, personelin e nevojshëm, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- a) Të paktën 2 (dy) punonjës të pajisur me certifikimin Cisco Certified Network Associate (CCNA) ose ekuivalente.

Çertifikata e kërkuar sipas pikës a) të kriterit 4, ka në thelb ka administrimin e pajisjeve si routera, switche si dhe implementimin e zgjidhjeve teknike (të tilla si: VLAN, protokolle trasmetimi të paketave RIP, EIGRP etj).

Është esenciale që stafi i Operatorit Ekonomik të jetë i trajnuar dhe i certifikuar sipas kushteve të kësaj certifikate ose ekuivalente me të, për të garantuar dhënien e suportit në rast problemi në pikat e ofrimit të shërbimit të internetit/intranetit të semaforëve, kamerave të Bashkisë Tiranë, duke garantuar shërbim cilësor dhe pa ndërprerje 24 orë/7 ditë të javës.

Qëllimi i kërkesës për të paktën 2 (një) punonjës të pajisur me certifikatë CCNA Certified Network Associate Routing & Switching ose ekuivalente; është që autoriteti kontraktor të garantohej se operatori ekonomik ka aftësinë e nevojshme në nivel stafi teknik për të kryer detyrat e për të përmbushur kontratën në tërësi.

- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar SCTE ose ekuivalente.

SCTE është një organizatë certifikuese e themeluar në vitin 1945, me qendër në Watford, Britani e Madhe dhe ofron një sërë kursesh dhe trajnimesh për profesionistë në fushën e telekomunikacionit, të cilat përgatisin inxhinierët për të punuar në kompanitë më të mëdha të fushës. SCTE ofron trajnime, seminare dhe mundësinë e akreditimit të antarëve të saj, njihet ndërkombëtarisht si një nga pesë organet certifikuese më të mira në fushën e teknologjisë së informacionit.

Çertifikatat SCTE kanë një bazë të gjerë të njohurive të ndërtimit të rrjetave dhe bazohen në testimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave të teknologjive të ndryshme si Fibra, Koaksial etj.

Pra **SCTE (Society of Cable Telecommunications Engineers)** është një certifikim ndërkombëtar që lidhet me:

- **Infrastrukturën HFC (Hybrid Fiber-Coax) dhe Fiber Optike**
- **Instalimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve kabllore dhe broadband**

- Transmetimin e **video-s (CCTV, IPTV, broadcast)**
- Testimin dhe diagnostikimin e sinjalit
- Standardet e cilësisë për rrjete fizike

Duke qenë se objekti i kontratës përfshin ndërtimin dhe operimin e një infrastrukture të shpërndarë me lidhje Dark Fiber dhe transmetim të vazhdueshëm të të dhënave dhe videos nga sistemet CCTV, kërkohen njohuri specifike në:

- instalimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve fizike të komunikimit,
- matjen dhe garantimin e cilësisë së sinjalit në rrjete fiber,
- identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve në nivel fizik të rrjetit,
- mbështetjen e transmetimeve multimediale me cilësi të lartë.

Ky certifikim siguron që personeli teknik është i kualifikuar për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm dhe cilësinë e rrjetit fizik, i cili është kritik për operimin pa ndërprerje të sistemit të monitorimit të trafikut.

Në zbatim të dispozitave ligjore të sipërpërmendura, kriteri i vendosur për **“Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar SCTE ose ekuivalente”** është në përputhje dhe përpjestim me objektin dhe volumin e kontratës së prokurimit, bazuar kjo në domosdoshmërinë e vijueshmërisë së shërbimeve 24/7 ditë të javës si dhe në shpërndarjen gjeografike të konsiderueshme të semaforëve kamerave në territorin e Bashkisë së Tiranës:

Për punonjesit e mesiperm, operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme;
- Certifikatat/ dëshmi profesionale/diplomë për specialistët e kërkuar;
- Listëpagesat sipas formularit e Sig25 për periudhën 2 (dy) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emer, mbiemër) / profilin e punonjësve (tipin e certifikatave përkatëse) nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 40, pika 5.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

“ 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit

ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.....”

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret tjerë të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmerinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik”, I ndryshuar, “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në rastet e dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

3. “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën e këtij objekti, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); V.K.B-së Nr. 131 dt 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025”; grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e investimit.

Specifikimi i parametrave teknik etj:

Termat e referencës dhe kërkesat funksionale/ specifikimet teknike hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar te njësisë së prokurimit.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut urban”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Loti i II-të: “Ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut urban – Shërbim data nëpërmjet kartave sim”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

c. Formularin e Ofertës Ekonomike, sipas **Shtojcës 1**

d. Lista e çmimeve të artikujve sipas **Shtojcës 3**

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.3 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.4 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Neni 43, pika 4, të VKM nr. 285 “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa

konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilanci e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë ***jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.*** (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit/ vlera e pritshme e kontratës së përllogaritur për lot, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c dhe pika 5, si dhe neni 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

Pika 2/a: dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;". Vlera e përllogaritur është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklaramentimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 43, pika 5, "Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 si dhe kështu përkatës për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo

anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, citohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të

përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë “Certifikatë e konfirmimit të njoftimit për sipërmarrësit” për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike sipas Regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, për shërbimet e kërkuara në këtë procedurë konkretisht për:

- Shërbim publik telefonik i lëvizshëm tokësor (për shërbimin e transmetimit të të dhënave nëpërmjet rrjetit të lëvizshëm

(Për operatorët e huaj ky kriter do të plotësohet duke dorëzuar licensën/autorizimin/certifikatën /dokumentin nga Autoritetet rregullatore përkatëse të origjinës së tyre).

Argumentimi:

Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

AKEP është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikqyr, kontrollon dhe monitoron veprimtaritë e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike. AKEP rezervon të drejtën të autorizojë një sipërmarrës/subjekt të ofrojë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, dhe i jep të drejtë të negociojë për interkoneksion dhe, kur është e zbatueshme, për të marrë akses nga sipërmarrësit e tjerë të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun si dhe të marri pjesë në përcaktimin si ofrues i shërbimit universal për shërbime të veçanta në skemën e shërbimit universal ose në pjesë të caktuara të territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, AKEP monitoron të gjithë infrastrukturën e çdo operatori i cili e ka të detyrueshme paraqitjen e shtrirjes së rrjetit të tij pranë AKEP sipas teknologjisë përkatëse që operatori disponon.

Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e certifikatës /autorizimit nga AKEP, për shërbimin objekt kontrate, është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kërkojë garanci mbi cilësinë e shërbimeve dhe të teknologjisë përkatëse që do të përdoret.

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Standartin ISO 9001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Standartin ISO 27001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- c) Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).*

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, nëpërputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

Argumentimi:

Bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"(i ndryshuar), Neni 44 - Kërkesat e cilësisë, pika 1, ku citohet:

"1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit."

- a) Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e ofrimit të shërbimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga ofruesi i shërbimit, fokusi i klientit, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca,

profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimeve që ofron, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit, siguri i konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin.

Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Referuar sa më sipër, kërkesa për ISO 9001, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

b) ISO 27001 është një kuadër standartizues përsa i përket garancisë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër, ky standard i kërkuar, lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi operatori ekonomik do të realizojë shërbimin e instalimit dhe konfigurimeve të nevojshme për vijueshmërinë e shërbimit nëpërmjet data sim card dhe shërbimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme përgjatë afatit të kontratës, për të garantuar mbarëvajtjen e proceseve teknologjike të punës, shërbime të cilat domosdoshmërisht kërkojnë akses në infrastrukturën e autoritetit. Aksesin në infrastrukturën ekzistuese të Bashkisë për të realizuar shërbimet sa më sipër do të jetë i kontrolluar e monitoruar nga stafi i Bashkisë, megjithatë certifikimi ISO 27001 i operatorit ekonomik është një garanci e nevojshme që kërkohet.

c) Standardi ISO 20000-1 përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohet në teknologjitë e informacionit.

Kjo certifikatë siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet IT do të menaxhohen sipas standardeve me të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit, pasi të gjithë elementët e kontratës dhe komponentët përbërës, lidhen me shërbime të teknologjisë së informacionit.

Këto kërkesa janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e shërbimit.

2.3.4 Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, për të realizuar instalimet dhe konfigurimet e kërkuara si dhe për të garantuar suportin dhe garancinë përgjatë periudhës së parashikuar sipas specifikimeve teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë minimalisht punonjës të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë CS PS Core Network Planning, ose ekuivalente;

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose më shumë certifikime.

Argumentimi:

Bazuar në nenin 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) përcaktohet:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- d) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- e) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- f) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...”*

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, personelin e nevojshëm, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë CS PS Core Network Planning, ose ekuivalente:

Certifikimi “CS PS Core Network Planning” ose ekuivalent është i nevojshëm për të garantuar që operatori ekonomik disponon staf të kualifikuar për planifikimin dhe dimensionimin e rrjeteve core (packet-switched), të cilat janë thelbësore për ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe me disponibilitet të lartë.

Duke qenë se objekti i kontratës përfshin rrjetet backup 3G/LTE/4G për një numër të madh pikash monitorimi (CCTV dhe nyje semaforike), kërkohet ekspertizë e avancuar në:

- projektimin e arkitekturës së rrjetit dhe redundancës,
- dimensionimin e trafikut dhe kapaciteteve,
- garantimin e cilësisë së shërbimit (QoS) për transmetime video dhe data në kohë reale,
- optimizimin e performancës së rrjetit core.

Ky certifikim siguron që personeli teknik ka njohuri të specializuara për të përballuar kompleksitetin dhe kriticitetin e këtij sistemi, duke minimizuar rrezikun e ndërprerjeve dhe degradimit të shërbimit.

Për Qendrën e Monitorimit të trafikut zgjidhja teknike e backup për nyjet e semaforëve është konceptuar nëpërmjet rrjetit GSM e cila bazohet në trasmetim 3G/4G/LTE. Operatori ekonomik duhet të ketë staf të certifikuar CS /PS Core Network Planning ose ekuivalente me të, për të realizuar rrjetin backup, për të garantuar shërbim 24 orë pa ndërprerje pasi ky lloj shërbimi është kritik për Institucionin.

Këto certifikata janë dizenuar për të siguruar njohuri për punonjësit në fushat si: bazat të rrjetit, radios dhe rrjetit të transportit, njohuri rreth planifikimit të rrjetit bazë.

Certifikimi me CS /PS Core Network Planning apo ekuivalente, i jep garanci Autoritetit Kontraktor për realizimin me sukses dhe në kohë të rrjetit dytësor backup për të garantuar shërbim 24 orë pa ndërprerje pasi ky lloj shërbimi është kritik për Bashkinë e Tiranës dhe nuk tolerohen ndërprerje.

Për punonjësit e mesiperm, operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme;
- Certifikatat/ dëshmi profesionale/diplomë për specialistët e kërkuar;
- Listëpagesat sipas formularit e Sig25 për periudhën 2 (dy) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emer, mbiemër) / profilin e punonjësve (tipin e certifikatave përkatëse) nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 40, pika 5.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

“ 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.....”

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të

operatorëve.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” , I ndryshuar, “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

3. “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën e këtij objekti, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin

e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); V.K.B-së Nr. 131 dt 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025”; grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e investimit.

Specifikimi i parametrave teknik etj:

Termet e referencës dhe kërkesat funksionale/ specifikimet teknike hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (I ndryshuar).

Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termet e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar të njësisë së prokurimit.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut urban”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.